



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Deklaratat përmbyllëse në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendimin për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve filluan sot dhe do të vijojnë edhe nesër, 11 shtator, dhe të hënë, 14 shtator 2026.

Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes lëshoi më 7 shtator një urdhër planifikimi, me të cilin caktoi tri orë për deklaratat përmbyllëse të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, dy orë për Mbrojtjen e Thaçit, një orë e gjysmë për Mbrojtjen e Smakajt, dy orë për secilin ekip të Mbrojtjes së z. Kilaj dhe z. Fazliu dhe 45 minuta për Mbrojtjen e z. Kuçi.

Përgjigjja e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ndaj deklaratave përmbyllëse të ekipeve të Mbrojtjes mund të zgjasë deri në një orë, përgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit 30 minuta, dhe përgjigjet e ekipeve të Mbrojtjes të z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi nga 15 minuta secili. Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes mund të bëjë pyetje në çdo kohë gjatë deklaratave përmbyllëse.

Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes urdhëroi që seancat të fillojnë në orën 9:30 paradite dhe mund të zgjasin deri në orën 5:15 pasdite.

Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi po marrin pjesë në këto seanca përmes videolidhjes, sipas kërkesës së tyre të miratuar nga Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes.

Deklaratat përmbyllëse janë publike dhe mund të përcillen në shqipe, anglishte dhe serbishte nëpërmjet transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së me 45 minuta vonesë, ose nga galeria për publikun në ndërtesën e gjykatës. Për ndjekjen e seancave nga mjediset e Gjykatës në Hagë duhej bërë regjistrim paraprak.

Pas deklaratave përmbyllëse, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes e deklaroi të mbyllur gjykimin dhe ka 90 ditë për kryerjen e vlerësimit dhe dhënien e vendimit.

Shqiptimi i aktgjykimit në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është caktuar të mbahet më 16 shtator 2026, dhe fillon në orën 10:00 paradite.

Kërkojmë mirëkuptimin e personave që nuk mund të jenë të pranishëm atë ditë në ndërtesë, pasi interesi për të përcjellë këtë seancë ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe u duhej dhënë përparësi familjarëve të ngushtë.





Seanca do të transmetohet përmes faqes transmetuese në internet, ku mund të shihet ngado në botë, në shqipe, anglishte ose serbishte, me një vonesë të shkurtër prej 10 minutash. Dhomat e Specializuara do të japin lidhjet edhe për faqe transmetuese alternative në rubrikën “Aktuale” në faqen e internetit dhe nëpërmjet një buletini për mediat që do të shpërndahet në fillim të javës që vjen. Kjo është një masë paraprake për të siguruar që të gjithë ata që dëshirojnë të mund ta përcjellin seancën.

